



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo

ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE MBETURINA
REGULATORNI URED ZA VODOVOD I OTPAD
WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE



RAPORT 6 MUJOR I KRU- ve MBI VLERESIMIN E PËRMBUSHJES SË CAQEVE TË PËRCAKTUARA ME PROCESIN RREGULLATORË TË VITIT 2010

Periodha e shikuar: 1 janar – 30 qershor 2010

**Punuar nga:
Departamenti për Financa dhe Tarifa Rregullatore (DFTRR/ZRRUM)**

Prishtinë, Tetor 2010

DFTRR/ZRRUM

Parathënie

Raporti i 6-mujorit të parë të vitit aktual (1 janar – 30 qershor 2011) vlerëson performancën e përmbushjes së cazeve të përcaktuara me procesin rregullatorë të 2010, dhe ep një pasqyrë të sektorit dhe të shtatë kompanive regjionale të shërbimeve të ujit.

Ky raport përmban dy pjesë në të cilin analizohet performanca relative e kompanive veç e veç dhe sektorit si tërësi.

Raporti është përgatit mbi bazën e të dhënave të deklaruar të kompanive në Departamentin e Përformancës (DP) në ZRRUM, sipas projektit të mbledhjes së të dhënave të Sistemit të Raportimit Financiarë, Operativë dhe të Shërbimeve për Konsumatorë (ROFK) dhe monitorimit të dhënave të tilla në data bazën e të dhënave të shtatë kompanive regjionale të sistemeve të ujit dhe kanalizimit.

Përmbajtja

1. HYRJE.....	4
2. ASPEKTET ADMINISTRATIVE	5
3. METODOLOGJIA TARIFORE	5
4. IDENTIFIKIMI I TREGUESËVE OPERATIV, FINANCIAR DHE INVESTIV	6
5. ANALIZA E PRODHIMIT DHE FATURIMIT.....	6
5.2 Paraqitja grafike e të dhënave për ujin e prodhuar dhe të faturuar sipas KRU-ve	8
6. ANALIZA E SHPENZIMEVE OPERATIVE	11
6.1 Mbulimi i shpenzimeve të përgjithshme operative nga shuma e arkëtimit	14
6.2 Paraqitja grafike e të dhënave për shpenzime operative sipas KRU-të	15
7. ANALIZA E FATURIMIT DHE INKASIMIT NË VLERË MONETARE.....	16
7.2 Paraqitja grafike e faturimit dhe inkasimit në vlerë monetare për KRU-të	18
8. INVESTIMET KAPITALE	20
8.1 Investimet Kapitale të Planifikuara	21
8.2 Investimet Kapitale të aprovuara prej ZRRUM.....	22
8.3 Investimet e realizuara gjatë periudhës 6 mujore të vitit 2010	23
8.5 Paraqitja grafike e investimeve kapitale	25

1. HYRJE

Raporti përmban pasqyra të treguesve kryesor; (i) operativ, (ii) financiar, (iii) investimeve kapitale, për shtatë (7) Kompanitë Regjionale të Ujit (KRU) të realizuara nga to, në periudhën; nga 1 Janar gjer më 30 Qershor 2010 dhe të dhënat e procesit rregullatorë të përcaktuara si objektive për 6 mujorin e parë dhe të dhënave investive kapitale vjetore të këtij viti.

Qëllimi i këtij raporti është;

- (i) Të epet një informacion për shkallën e përmbushjes së cazeve të përcaktuara me procesin rregullatorë të vitit 2010, i cili do të shërbej si informacion; kompanive, ZRRUM-it dhe palëve tjera të interesit;
- (ii) Analiza e të dhënave të tilla do të jenë udhërrëfyes për angazhim të mëtutjeshëm të DFTRR/ZRRUM, për pjesën e mbetur të vitit 2010 dhe atij të vitit 2011, nga procesi trevjeçarë tariforë 2009-2011 dhe në veçanti efektet e ndikimit të tarifave në realizim të projekteve të investimeve kapitale me financim të brendshëm financiarë, etj.

Prezantimi i të dhënave të këtij raporti mbi përmbushjen e cazeve të përcaktuara me procesin rregullatorë për periudhat tani historike 6 mujore të viti 2009, dhe të pjesës së parë të vitit 2010, bazohet në tri shtylla kryesore. Të dhënat e tilla i quajmë historike pasi që të njëjtat tani më janë përmbyllura, të cilat prezantohen si:

- a) të dhëna historike 6 mujore të vitit 2009,
- b) të dhënat historike të aprovuara me marrëveshje; KRU – ZRRUM për të njëjtën periudhë të vitit 2010, dhe
- c) të dhënat e treguesve të arritur nga kompanitë gjatë 6 mujorit të vitit 2010.

Me konkluzionet e këtij raporti do të njoftohen përfaqësuesit kompanive dhe palët tjera të interesit.

2. ASPEKTET ADMINISTRATIVE

Analiza dhe monitorimi i treguesve kryesorë operativë financiarë të KRU-ve të përcaktuar me procesin rregullatorë 2009-2011 është mbështetur në Ligjin Nr. 03/L-086, *Mbi Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004/49, për Veprimtaritë e Shërbimeve të Ujësjellësve, Kanalizimeve dhe të Mbeturinave*, dhe të Rregullës R-02/UeK, të datës 12.08.2008, *Për Përcaktim të Tarifave të Shërbimit për Shërbimet e Ujësjellësit, Ujërave të zeza, dhe të Furnizimit të Ujit me Shumicë në Kosovë*, neni 26, pika a. dhe b.

Identifikimi i efekteve të tarifave në caqet e përcaktuara të treguesve operativë-financiarë dhe ato të investimeve kapitale për vitin 2010, është vendimtar për aktivitetet e mëtutjeshme të vet kompanive, nëse janë pozitive do të ndikojnë në ngritjen e nivelit të shërbimit, efikasitetit të tyre më të mirë dhe realizimin e synimeve të kompanive dhe ZRRUM-it, të cilat janë të ndërlidhura me interesin e përgjithshëm shoqëror.

Nga aspekti administrativ DFTRR/ZRRUM mund të ndërmerr veprime të caktuara administrative me qëllim të përshtatjes së rrethanave të reja të krijuara nga procesi i gjertanishëm tarifor, të cilat mund të jenë ndikuar nga faktorët e theksuar në këtë publikim.

Të gjitha veprimet eventuale që mund ti ndërmarr ZRRUM, do të jenë në pajtim me rrethanat apo situatat e caktuara që mund të paraqiten dhe të njëjtat do të ndërmerren pas konsultimeve të ndërsjella me palët e interesit.

3. METODOLOGJIA TARIFORE

Politika dhe metodologjia e përdorur për përcaktim të tarifave 2009-2011, dallon nga ajo e përdorur në dy proceset tjera paraprake. Për këtë qëllim DFTRR/ZRRUM ka pas mbështetjen e konsulentëve ndërkombëtar, me që rast janë zhvilluar metodologji të reja tarifore, bazuar në praktikën e mira të rregullatorëve tjerë ekonomik të shërbimeve të ujit, sikurse që janë ato të shteteve të Britanisë së Madhe, duke pasur parasysh edhe specifikat tona aktuale.

Kjo metodologji bazohet në kategoritë vijuese ekonomike, si:

- (i) mbulimin e shpenzimeve operative dhe atyre të investimeve kapitale,
- (ii) marrjen parasysh të shumës së amortizimit për asetet jo-infrastrukturore,
- (iii) përcaktimin e vlerës rregullatore të kapitalit,
- (iv) marrjen në konsideratë për të llogaritur edhe normën e kthimit në vlerën rregullatore të kapitalit,
- (v) fillimin e mbajtjes së kontabilitetit rregullator për çdo kosto qendër veç e veç, me theks të veçantë të shërbimit ujësjellësit dhe atë të kanalizimit, etj.

Kalimi nga sistemi i përcaktimit të tarifave 1-vjeçare në atë 3-vjeçare ka ndikuar në ndërrimin e metodologjisë së përcaktimit të tarifave që llogaritet si pikë kthese për fillimin e realizimit të investimeve kapitale, për:

- (i) sigurimin e burimeve të reja me ujë,
- (ii) zëvendësimin dhe zgjerim e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit,

- (iii) ngritjen e nivelit të shërbimit,
- (iv) ndikimin në ngritjen e vazhdueshme të qëndrueshmërisë financiare të vet kompanive etj.

Me procesin rregullatorë të vitit 2009 -2011, për secilën prej KRU-ve janë përgatitur pasqyrat e të hyrave të planifikuara në bazë të parasë së gatshme, ku është llogaritur edhe profiti i mundshëm në fund të çdo viti afarist, të cilin profit KRU-të duhet ta investojnë për ta zgjeruar bazën e tyre materiale, me të dhënat e planifikuara të cilat janë akorduar me ZRRUM-in.

Në rast të mos përmbushjes së planeve të investimeve kapitale, të cilat në vete përmbajnë të hyra që duhet të investohen në projekte kapitale të cilat i kanë afektuar tarifat e përcaktuara, mund të kenë si pasojë rishikimin e tarifave për vitin pasues, pasi që mund të konsiderohet se pa të drejtë janë ngarkuar konsumatorët me një pjesë të tarifës e cila nuk po përdoret për qëllimin e parapërcaktuar.

Zgjerimi i bazës së kostove të reja të cilat e kanë ngarkuar tarifën, sikurse u theksua edhe më lartë i jep të drejtë KRU-ve që mjetet e fituara financiare ti përdorin për investime kapitale, sikurse edhe ato të tjerat të huazuara mbi bazën e kredive komerciale, nëse do të ketë raste të tilla etj.

4. IDENTIFIKIMI I TREGUESËVE OPERATIV, FINANCIAR DHE INVESTIV

Treguesit e identifikuar si kryesorë të cilët janë marrë dhe do të merren në konsideratë për tu analizuar dhe monitoruar gjatë vlefshmërisë së tarifave ekzistuese për këtë proces rregullatorë do të dalin nga të dhënat e tilla të aprovuara në marrëveshje me kompanitë dhe ato të realizuara nga KRU-të, gjatë periudhës kohore Janar-Qershor 2010, të krahasuara edhe me periudhën e njëjtë kohore të vitit 2009.

Grupimet e tregueseve të identifikuar, janë:

- (i) sasia e ujit të prodhuar,
- (ii) sasia e ujit të humbur
- (iii) sasia e ujit të faturuar
- (iv) sasia e ujërave të zeza të mbledhura
- (v) numri i konsumatorëve
- (vi) shuma e shpenzimeve operative
- (vii) vlera monetare e faturimit
- (viii) shuma e planifikuar e inkasimit
- (ix) shuma e projekteve investive të planifikuara dhe realizuara gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2010 prej burimeve vetanake,
- (x) shuma e projekteve investive të planifikuara për realizim nga donatorët potencial të cilat edhe pse nuk ndikojnë në tarifë, monitorohet shkalla e realizimit të tyre.

Të dhënat e realizuara gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2010, janë kalkuluar duke marrë për bazë gjithë vitin 2010 dhe pastaj të pjesëtuar me dy (2) për të fituar të dhënat 6-mujore.

5. ANALIZA E PRODHIMIT DHE FATURIMIT

Të dhënat e mbledhura në këtë grupim do ti paraqesim në formë tabelore, me qëllim krahasimi më të lehtë të caceve të përcaktuara rregullatore për 6 muajt e parë të vitit 2010. Konkluzionet e nxjerra nga kjo tabelë mund të jenë udhërrëfyes për përmirësim të performancës së tyre deri në përmbyllje të këtij viti, si dhe të vitit pasues 2011.

Tabela Nr.1 Të dhënat sasiore për ujin e prodhuar, ujin e humbur, ujin e faturuar dhe të ujërave të zeza të faturuara.

Emri i Kompanisë	Të dhënat	Njësia	Historike 2009	Aprovuara 2010	Realizuar a 2010	%	Vlerësimi përfundimtar 2010
Prishtina	Uji i prodhuar	m ³	22,552,690	22,860,000	22,277,202	-3	Negativ
	Uji i humbur		12,107,039	9,505,950	11,892,178	+25	Negativ
	Uji i faturuar		10,445,651	13,354,050	10,385,024	-22	Negativ
	Ujërat e zeza të faturuara		9,012,246	11,484,483	8,931,121	-22	Negativ
	Numri i konsumatorëve	Nr	86,491	72,289	87,853	+22	Pozitiv
Mitrovica	Uji i prodhuar	m ³	8,679,297	8,290,000	8,640,933	+4	Pozitiv
	Uji i humbur		4,447,624	3,689,750	4,499,439	+22	Negativ
	Uji i faturuar		4,231,673	4,600,251	4,141,494	-10	Negativ
	Ujërat e zeza të faturuara		3,890,980	2,197,192	3,474,601	+58	Pozitiv
	Numri i konsumatorëve	Nr	21,314	20,080	20,614	+3	Pozitiv
Hidrodrini	Uji i prodhuar	m ³	14,096,230	15,000,000	14,481,574	-3	Negativ
	Uji i humbur		10,454,015	11,160,065	10,661,594	-4	Pozitiv
	Uji i faturuar		3,642,215	3,839,936	3,819,980	-1	Negativ
	Ujërat e zeza të faturuara		3,531,182	1,996,767	1,986,390	-1	Negativ
	Numri i konsumatorëve	Nr	30,896	30,065	31,991	+6	Pozitiv
Radoniqi	Uji i prodhuar	m ³	7,581,144	8,612,534	7,647,548	-11	Negativ
	Uji i humbur		4,183,118	4,123,783	4,480,624	+9	Negativ
	Uji i faturuar		3,398,026	4,488,751	3,166,924	-29	Negativ
	Ujërat e zeza të faturuara		1,186,142	2,495,747	1,760,810	-29	Negativ
	Numri i konsumatorëve	Nr	27,230	27,783	27,468	-1	Negativ
Hidroregjioni Jugor	Uji i prodhuar	m ³	7,622,488	6,028,908	7,186,148	+19	Pozitiv
	Uji i humbur		4,210,443	2,071,457	4,256,113	+105	Negativ
	Uji i faturuar		3,412,046	3,957,451	2,930,035	-26	Negativ
	Ujërat e zeza të faturuara		3,139,082	3,688,965	2,731,252	-26	Negativ
	Numri i konsumatorëve	Nr	31,230	28,195	31,401	+11	Pozitiv
Bifurkacioni	Uji i prodhuar	m ³	2,544,320	3,268,230	2,982,071	-9	Negativ
	Uji i humbur		1,455,242	1,391,410	1,864,722	+34	Negativ
	Uji i faturuar		1,089,078	1,876,820	1,117,349	-40	Negativ
	Ujërat e zeza të faturuara		919,006	1,601,235	953,282	-40	Negativ
	Numri i konsumatorëve	Nr	13,694	18,750	14,740	-21	Negativ
Hidromorava	Uji i prodhuar	m ³	3,468,750	4,519,000	3,592,130	-21	Negativ
	Uji i humbur		1,977,160	1,807,356	2,166,233	+20	Negativ
	Uji i faturuar		1,491,591	2,711,644	1,425,897	-47	Negativ
	Ujërat e zeza të faturuara		1,357,347	2,494,713	1,311,825	-47	Negativ
	Numri i konsumatorëve	Nr	16,676	17,422	16,916	-3	Negativ


Tabela Nr. 2 Të dhënat sektoriale për ujin e prodhuar, ujin e humbur, ujin e faturuar dhe të ujërave të zeza të faturuara.

Të dhënat	Njësia	Historike 2009	Aprovuar a 2010	Realizuar a 2010	%	Vlerësimi përfundimtar
Uji i prodhuar	m ³	66,544,917	68,578,671	66,807,606	-3	Negativ
Uji i humbur		38,834,640	33,749,770	39,820,903	+18	Negativ
Uji i faturuar		27,710,278	34,828,902	26,986,703	-23	Negativ
Ujërat e zeza të faturuara		23,035,985	25,959,101	21,149,280	-19	Negativ
Numri i konsumatorëve	Nr	227,531	214,584	230,982	+8	Pozitiv


5.2 Paraqitja grafike e të dhënave për ujin e prodhuar dhe të faturuar sipas KRU-ve

Në vijim do të paraqiten në mënyrë grafike të dhënat e veçanta të çdo kompanie për prodhimin dhe humbjen e ujit si dhe të dhënave sasiore të ujit dhe ujërave të zeza të faturuara. Këto diagrame si të tilla nuk do të komentohen pasi që përmes tyre mund të vërehet qartë shkalla e realizueshmërisë së caceve të caktuara nga ZRRUM, si dhe krahasimi i tyre me periudhën e njëjtë kohore të vitit paraprak.


Diagrami Nr. 1 Prodhimi i ujit në m³




Diagrami Nr. 2 Uji i humbur në m³




Diagrami Nr. 3 Uji i faturuar në m³



Diagrami Nr. 4 Ujërat e zeza të faturuara në m³



Diagrami Nr. 5 Numri i Konsumatorëve



6. ANALIZA E SHPENZIMEVE OPERATIVE

Të dhënat e mbledhura në këtë grupim do ti paraqesim në formë tabelore të thjeshtësuar, me qëllim krahasimi më të lehtë të cazeve të përcaktuara rregullatore dhe afarizmit 6-mujorë të KRU-ven për vitin aktual dhe atë paraprakë.

Shënim: *Celulat e pa plotësuara në tabelën e mëposhtme nuk kanë mundur të vlerësohen, për mungesë të dhënave të kompanive përkatëse.*

Kërkohet që të njëjtat të fillojnë ti mbajnë shënimet e tilla pa përjashtim

Tabela Nr. 3 Analiza e shpenzimeve operative për periudhën 6 mujore të vitit 2010

Emri i Kompanisë	Të dhënat e shpenzimeve financiare	Njësia	UJË					KANALIZIM				
			Historike 2009	Aprovuar 2010	Realizuar 2010	%	Vlerës. përfund. 2010	Historike 2009	Aprovuar 2010	Realizuar 2010	%	Vlerës. përfund. 2010
Prishtina	Stafi (personeli)	€	1,289,123	1,502,050	1,189,288	-21	Pozitiv	70,100	180,800	70,259	-61	Pozitiv
	Energjia elektrike	€	916,974	749,800	1,213,080	+62	Negativ	3,853	19,850	5,208	-74	Pozitiv
	Shpenzimet tjera operative	€	870,076	1,149,650	508,887	-56	Pozitiv	6,920	49,250	7,341	-85	Pozitiv
	Σ e shpenzimeve operative	€	3,076,172	3,401,500	2,911,255	-14	Pozitiv	80,873	249,900	82,808	-67	Pozitiv
Mitrovica	Stafi (personeli)	€	412,595	425,500	439,806	+3	Negativ	25,686	50,500	28,810	-43	Pozitiv
	Energjia elektrike	€	158,433	122,000	152,731	+25	Negativ	0	19,000	0	!	!
	Shpenzimet tjera operative	€	332,730	285,000	261,768	-8	Pozitiv	10,842	56,000	40,238	-28	Pozitiv
	Σ e shpenzimeve operative	€	903,758	832,500	854,306	+3	Negativ	36,528	125,500	69,048	-45	Pozitiv
Hidrodrini	Stafi (personeli)	€	34,366	295,550	428,290	+45	Negativ	20,801	50,100	22,544	-55	Pozitiv
	Energjia elektrike	€	155,671	75,950	171,555	+126	Negativ	0	0	0	0	!
	Shpenzimet tjera operative	€	164,469	262,400	119,232	-55	Pozitiv	7,884	96,900	15,302	-84	Pozitiv
	Σ e shpenzimeve operative	€	354,505	633,900	719,076	+13	Negativ	28,685	147,000	37,846	-74	Pozitiv
Radoniqi	Stafi (personeli)	€	599,478	627,350	593,583	-5	Pozitiv	42,679	47,400	43,742	-8	Pozitiv
	Energjia elektrike	€	69,139	71,200	74,429	+5	Negativ	10	0	1,961	+	Negativ
	Shpenzimet tjera operative	€	225,453	195,450	203,533	+4	Negativ	5,065	7,900	6,848	-13	Pozitiv
	Σ e shpenzimeve operative	€	894,069	894,000	871,545	-3	Pozitiv	47,753	55,300	52,551	-5	Pozitiv
Hidroregjioni Jugor	Stafi (personeli)	€	428,052	417,350	447,461	+7	Negativ	52,904	20,550	55,303	+169	Negativ
	Energjia elektrike	€	232,549	190,900	212,250	+11	Negativ	31,038	14,100	26,233	+86	Negativ
	Shpenzimet tjera operative	€	283,976	191,900	142,534	-26	Pozitiv	9,602	26,250	7,489	-71	Pozitiv
	Σ e shpenzimeve operative	€	944,577	800,150	802,245	+0.3	Negativ	93,544	60,900	89,026	+46	Negativ
Bifurkacioni	Stafi (personeli)	€	172,716	112,700	188,410	+67	Negativ	19,457	60,800	35,289	-42	Pozitiv
	Energjia elektrike	€	16,145	8,900	25,356	-185	Negativ	0	2,150	0	-100	Negativ
	Shpenzimet tjera operative	€	73,809	97,500	37,993	-61	Pozitiv	2,778	68,550	5,476	-92	Pozitiv
	Σ e shpenzimeve operative	€	262,669	219,100	251,758	+15	Negativ	22,234	131,500	40,765	-69	Pozitiv
Hidromorava	Stafi (personeli)	€	164,337	223,900	221,350	-1	Pozitiv	12,778	55,950	22,861	-59	Pozitiv
	Energjia elektrike	€	54,843	28,250	84,272	+198	Negativ	147	7,050	0	-100	Pozitiv
	Shpenzimet tjera operative	€	296,680	239,300	127,310	-47	Pozitiv	5,604	59,850	5,202	-91	Pozitiv
	Σ e shpenzimeve operative	€	515,859	491,450	432,932	-12	Pozitiv	18,528	122,850	28,064	-77	Pozitiv

PS.: Vlerësimi përfundimtarë për zërin e caktuar të shpenzimeve të energjisë elektrike të ujërat e zeza, te kompanitë e “Radoniqi”, “Hidromorava” dhe “Bifurkacioni” nuk janë mbajt ose prezantuar si dhuat. Kërkohet që kjo të tejkalohet te rastet tjera të prezantimit të dhënave të tilla.

Tabela Nr. 4 Të dhënat sektoriale të shpenzimeve operative

Të dhënat e shpenzimeve financiare	Njësia	UJË					KANALIZIM				
		Historike 2009	Aprovuar 2010	Realizuar 2010	%	Vlerës. përfund. 2010	Historike 2009	Aprovuar 2010	Realizuar 2010	%	Vlerësimi Përfundimtar, 2010
Stafi (personeli)	€	3,100,664	3,604,400	3,508,188	-3%	Pozitiv	244,404	466,100	278,809	-40%	Pozitiv
Energjia elektrike	€	1,603,753	1,247,000	1,933,674	+55%	Negativ	35,047	62,150	33,402	-46%	Pozitiv
Shpenzimet tjera operative	€	2,247,192	2,421,200	1,401,256	-42%	Pozitiv	48,693	364,700	87,897	-76%	Pozitiv
Σ e shpenzimeve operative	€	6,951,608	7,272,600	6,843,118	-6%	Pozitiv	328,144	892,950	400,108	-55%	Pozitiv

Shumica e KRU-ve kanë rënie të lehtë të shpenzimeve operative, këtë e vërteton edhe tabela me të dhënat përmbledhëse të sektorit. Shpenzimet totale operative në sektorin e ujit janë ulur për 6.0% krahasuar me caqet e përcaktuara edhe pse numri i konsumatorëve është rritur për 8%.

Ulja e kostove të shërbimit, përkundër ngritjes së numrit të konsumatorëve të shërbyer mund të jetë një tregues i mirë dhe mund të komentohet në forma të ndryshme.

6.1 Mbulimi i shpenzimeve të përgjithshme operative nga shuma e arkëtimit

Tabela. Nr. 5 Të dhënat e mbulueshmërisë së shpenzimeve të përgjithshme operative të ndodhura gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2010, në këtë tabelë ka hy edhe shuma e investimeve vetanake

NR	KRU	Të hyrat €	Shpenzimet Operative €	Mbetja Financiare €	Investimet Kapitale vetanake (€)	Shkalla e mbulueshmërisë
1	Prishtina	3,356,179	2,994,063	362,116	146,828	1.121
2	Mitrovica	492,699	923,354	(430,655)	-	0.534
3	Hidrodrini	688,907	756,922	(68,015)	24,048	0.910
4	Radoniqi	789,780	924,096	(134,316)	11,056	0.855
5	Prizreni	829,946	891,271	(61,325)	78,157	0.931
6	Bifurkacioni	304,251	292,523	11,728	17,872	1.040
7	Hidromorava	392,608	460,996	(68,388)	22,500	0.852
	Të dhënat sektoriale	6,854,370	7,243,225	(388,855)	300,461	0.946


PS.: KRU "Mitrovica" sh.a Mitrovicë është rast specifik pasi që për sasinë e ujit të trajtuar me të cilën e furnizon pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës, nuk arkëton asnjë shumë nga konsumatori i vet. Por në anën tjetër, Qeveria e Republikës së Kosovës me subvencionet e veta, mbulon zërat e caktuar të shpenzimeve operative, ose ndërmerr financimin e projekteve të caktuara kapitale investive për të njëjtën, si kompensim për shpenzimet e ndodhura në këtë kompani.

Të dhënat e KRU "Mitrovica" sh. a. Mitrovicë e kanë përkeqësuar edhe gjendjen e sektorit. ë


6.2 Paraqitja grafike e të dhënave për shpenzime operative sipas KRU-të

ZRRUM nuk do ti komentoj as të dhënat grafike të paraqitura më poshtë për shpenzimet operative për secilën KRU veç e veç, pasi që në të njëjtën mund të vërehen lëvizjet figurative të shpenzimeve të tilla, duke i krahasuar me shumat operative të shpenzimeve të aprovuara si dhe duke i krahasuar të njëjtat me periudhën e njëjtë kohore edhe të vitit 2009.

Diagrami Nr .6 Shpenzimet operative për ujë



Diagrami Nr. 7 Shpenzimet Operative për kanalizim



7. ANALIZA E FATURIMIT DHE INKASIMIT NË VLERË MONETARE

Në këtë grupim të dhënave do të pasqyrohen caqet e përcaktuara me procesin rregullatorë për 6 mujorin e parë vitet 2009 dhe atë të vitit 2010.

Ndërsa në dy tabelat tjera, Nr. 6.1 dhe nr. 7 do të pasqyrohen shkallët e realizimit të objektivave të caktuara për çdo kompani veç e veç dhe për sektorin në përgjithësi.

Tabela Nr. 6 Të dhënat e faturimit dhe inkasimit në vlerë monetare për të dy shërbimet si dhe shumave nga tarifa fikse

Emri i Kompanisë	Të dhënat financiare	Njësia	Kategoritë e shpenzimeve dhe numri i konsumatorëve						Σ e tarifës fikse	Σ e tarifës fikse	Σ e faturimit dhe inkasimit për ujë dhe kanalizim	
			Ujë			Kanalizim						
			Realizuara 2009	Aprovuara 2010	Realizuara 2010	Realizuara 2009	Aprovuara 2010	Realizuara 2010	Aprovuar 2010	Realizuar 2010	Aprovuara 2010	Realizuara 2010
Pishtina	Faturimi	€	4,037,157	5,565,950	4,391,515	362,252	585,700	417,269	520,450	565,586	6,672,100	5,374,370
	Inkasimi	€	3,228,975	4,261,340	2,742,407		447,050	260,575	384,220	353,196	5,092,610	3,356,179
Mitrovica	Faturimi	€	796,008	978,950	792,574	116,814	150,700	109,064	142,400	143,024	1,272,050	1,044,662
	Inkasimi	€	541,140	745,105	373,806		116,444	51,438	104,638	67,455	966,187	492,699
Hidrodrini	Faturimi	€	847,149	943,200	1,007,677	101,100	137,300	107,331	251,850	222,136	1,332,350	1,337,144
	Inkasimi	€	701,923	718,092	519,163		104,691	55,298	186,325	114,446	1,009,108	688,907
Radoniqi	Faturimi	€	963,296	1,514,700	1,001,123	106,907	121,300	106,943	209,750	204,994	1,845,750	1,313,061
	Inkasimi	€	874,467	1,135,436	602,156		91,048	64,324	157,049	123,300	1,383,533	789,780
Hidroregjioni Jugor	Faturimi	€	980,365	1,180,250	922,827	143,085	179,650	125,269	218,850	220,971	1,578,750	1,269,067
	Inkasimi	€	807,096	877,155	603,512		266,659	81,923	162,089	144,511	1,305,902	829,946
Bifurkacioni	Faturimi	€	324,243	449,300	354,920	51,941	262,800	67,313	144,250	96,109	856,350	518,341
	Inkasimi	€	281,154	316,948	208,328		185,938	39,511	106,191	56,413	609,076	304,251
Hidromorava	Faturimi	€	471,616	817,850	461,397	88,555	198,600	91,219	131,100	114,816	1,147,550	667,432
	Inkasimi	€	420,226	664,995	271,411		161,136	53,659	107,040	67,539	933,171	392,608
Shuma e përgjithshme	Faturimi	€	8,419,833	11,450,200	8,932,034	970,653	1,636,050	1,024,408	1,618,650	1,567,635	14,704,900	11,524,077
	Inkasimi	€	6,854,980	8,719,070	5,320,782	0	1,372,965	606,729	1,207,551	926,860	11,299,586	6,854,371

PS.: Celulat të cilat janë të zbrazëta, kanë mbetur si pasojë e mungesës së të dhënave nga KRU-të.

Tabela Nr. 6.1. Vlerësimi përfundimtar i faturimit dhe inkasimit në vlerë monetare

Emri i Kompanisë	Të dhënat financiare	Njësia	Faturimi dhe inkasimi për dy shërbimet		%	Vlerësimi përfundimtar
			Aprovuara 2010	Realizuara 2010		
Prishtina	Faturimi	€	6,672,100	5,374,370	-19	Negativ
	Inkasimi	€	5,092,610	3,356,179	-34	Negativ
Mitrovica	Faturimi	€	1,272,050	1,044,662	-18	Negativ
	Inkasimi	€	966,187	492,699	-49	Negativ
Hidrodrini	Faturimi	€	1,332,350	1,337,144	0.4	Pozitiv
	Inkasimi	€	1,009,108	688,907	-32	Negativ
Radoniqi	Faturimi	€	1,845,750	1,313,061	-29	Negativ
	Inkasimi	€	1,383,533	789,780	-43	Negativ
Hidroregjioni Jugor	Faturimi	€	1,578,750	1,269,067	-20	Negativ
	Inkasimi	€	1,305,902	829,946	-36	Negativ
Bifurkacioni	Faturimi	€	856,350	518,341	-39	Negativ
	Inkasimi	€	609,076	304,251	-50	Negativ
Hidromorava	Faturimi	€	1,147,550	667,432	-42	Negativ
	Inkasimi	€	933,171	392,608	-58	Negativ


Tabela Nr. 7 Të dhënat sektoriale për faturim dhe inkasim në vlerë monetare

Të dhënat financiare	Njësia	Faturimi dhe inkasimi për dy shërbimet		%	Vlerësimi përfundimtar
		Aprovuara 2010	Realizuara 2010		
Faturimi	€	14,704,900	11,524,077	-22	Negativ
Inkasimi	€	11,299,586	6,854,371	-39	Negativ


7.2 Paraqitja grafike e faturimit dhe inkasimit në vlerë monetare për KRU-të

Në vijim do të paraqiten në mënyrë grafike të dhënat e faturimit dhe inkasimit në vlerë monetare. Nga forma e tyre shihet shkalla e realizueshmërisë së objektivave të caktuara sipas marrëveshjes KRU-ZRRUM, si dhe krahasimi i tyre me periudhën e njëjtë kohore të vitit paraprak.


Diagrami Nr. 8 Diagrami i faturimit të ujit në vlerë monetare



Diagrami Nr. 9 Diagrami i inkasimit në vlerë monetare



Diagrami Nr. 10 Diagrami i ujërave të zeza të faturuara në vlerë monetare



8. INVESTIMET KAPITALE

Kosova pas luftës trashëgoi infrastrukturë ujore shumë të dëmtuar, si dhe përqindje të vogël të mbulueshmërisë së popullatës me ujë të pijes. Andaj, duke pasur parasysh këtë fakt, sektorit të ujërave në Kosovë, i takon sektorëve në të cilin janë orientuar një numër i konsiderueshëm i projekteve dhe investimeve kapitale. Në vazhden e kësaj duhet theksuar se shumë donatorë kanë dhënë donacione për rehabilitimin dhe ngritjen e infrastrukturës ujore në përgjithësi.

Me aprovimin e tarifave të reja për periudhën afatmesme 2009-2011 janë paraparë që të ndërmerren investime të konsiderueshme kapitale nga të gjitha kompanitë e ujësjellësit. Këto investime janë të domosdoshme për sistemet e ujësjellësit dhe kanalizimit të cilat do të mundësojnë shërbime më cilësore për konsumatorë dhe ngritje të ngadalshme të vlerës së aseteve të tyre.

Avancimit të këtij procesi tarifor, ZRRUM i ka kushtuar një pjesë të madhe të angazhimit të tij, prej fillimit të aplikimit të tarifave të reja gjatë vitit 2009. Kjo ka kërkuar edhe monitorim të rregullt për të vlerësuarin efektet e tarifave dhe në veçanti dinamikën e realizimit të projekteve për investime të projektuara.

Disa sqarime mbi klasifikimin e shërbimeve, edhe për investimet e projektuara kapitale.

Duke u bazuar në metodologjinë e re tarifore e cila kërkon edhe mbajtjen e rregullat të Kontabilitetit Rregullatorë (KRR) nëpër kosto qendrat e shërbimeve, ZRRUM, investimet kapitale i ka klasifikuar si investime në **shërbimet e ujësjellësit** dhe **kanalizimit**. Më pastaj, investimet në asetet e ujësjellësit dhe kanalizimit janë ndarë në: **asetet e infrastrukturës** dhe në ato të **jo-infrastrukturës**.

Investimet kapitale në **Asetet Infrastrukturore** janë të ndara në investime të cilat bëhen për qëllime të zëvendësimit të infrastrukturës dhe në investime të zgjerimit të saj. Këto Investime karakterizohen si investime në asete nëntokësore siç janë; gypat, pusetat, digat, rezervuarët nëntokësore, kanalet e ujit etj.

Investimet kapitale në **Asetet Jo-Infrastrukturore** bëjnë pjesë të gjitha asetet mbitokësore siç janë; fabrikat për trajtimin e ujit, ndërtesat administrative, mjetet transportuese, pajisjet për zyrë etj.

Ky raport përmbledh të dhënat krahasuese të periudhave të shikuara vjetore 2009 dhe atë të 6 mujorit të parë të vitit 2010.

Të dhënat e tilla do të analizohen shkurtimisht dhe do të komentohen me qëllim të ndërmarrjes së masave për përmirësim të gjendjes ekzistuese të shumica e kompanive, pasi që kjo është e evidente se treguesit nuk janë të mirë për periudhën e shikuar.

8.1 Investimet Kapitale të Planifikuara

Gjatë dorëzimit të dhënave nga KRU-të për të përcaktuar tarifat e viteve 2009-2010, kanë qenë të obliguar të paraqesin planifikimet e tyre të investimeve kapitale për periudhën e njëjtë kohore. Në tabelën vijuese janë paraqitur të grupuara investimet e planifikuara për të gjitha KRU-të që operojnë në Kosovë, duke klasifikuar investimet e tyre për shërbimet e ujit dhe kanalizimit nga burimet financiare vetanake dhe ato të donatorëve të ndryshëm.

Investimet e planifikuara nga KRU-të, ZRRUM i ka marrë në konsideratë dhe më pastaj në bazë të dhënave tjera operative dhe financiare ka determinuar shkallën e lejuar të investimeve vetanake të cilat kompanitë mund ti mbulojnë me të hyrat e veta të cilat paraqiten në Tabelën Nr. 5.

Ndërsa investimet kapitale të cilat janë planifikuar të realizohen nga donatorët të ndryshëm, janë aprovuar me marrëveshje sipas shumës së prezantuar nga kompanitë.

Tabela Nr.8 Investimet e Planifikuara prej KRU-ve nga burimet vetanake dhe donatorëve për vitin 2010 (Euro)

Emri i Kompanisë	Kategoria e Investimeve	Investimet e planifikuara Vetanake			Investimet e planifikuara nga Donacionet		
		Ujë	Kanalizim	Totali	Ujë	Kanalizim	Totali
Prishtina	Infrastrukturë	1,234,700	77,000	1,311,700	7,532,000	1,000,000	8,532,000
	Jo-Infrastrukturë	1,315,800	400,000	1,715,800	14,541,340	4,700,000	19,241,340
	Totali	2,550,500	477,000	3,027,500	22,073,340	5,700,000	27,773,340
Mitrovica	Infrastrukturë	210,900	8,700	219,600	313,300	71,700	385,000
	Jo-Infrastrukturë	414,600	8,000	422,600	131,000	0	131,000
	Totali	625,500	16,700	642,200	444,300	71,700	516,000
Hidrodrini	Infrastrukturë	523,500	413,700	937,200	260,000	20,000	280,000
	Jo-Infrastrukturë	165,000	140,000	305,000	0	0	0
	Totali	688,500	553,700	1,242,200	260,000	20,000	280,000
Radoniqi	Infrastrukturë	141,300	50,025	191,325	350,000	0	350,000
	Jo-Infrastrukturë	620,000	0	620,000	2,200,000	0	2,200,000
	Totali	761,300	50,025	811,325	2,550,000	0	2,550,000
Hidroregjioni Jugor	Infrastrukturë	241,900	227,200	469,100	2,014,580	5,178,647	7,193,227
	Jo-Infrastrukturë	173,700	50,000	223,700	79,779	4,500,000	4,579,779
	Totali	415,600	277,200	692,800	2,094,359	9,678,647	11,773,006
Bifurkacioni	Infrastrukturë	485,000	229,500	714,500	425,000	0	425,000
	Jo-Infrastrukturë	235,000	35,500	270,500	0	0	0
	Totali	720,000	265,000	985,000	425,000	0	425,000
Hidromorava	Infrastrukturë	20,050	20,100	40,150	0	0	0
	Jo-Infrastrukturë	335,800	0	335,800	100,000	0	100,000
	Totali	355,850	20,100	375,950	100,000	0	100,000
Totali i investimeve		6,117,250	1,659,725	7,776,975	27,946,999	15,470,347	43,417,346

8.2 Investimet Kapitale të aprovuara prej ZRRUM

Bazuar në të dhënat operative, shumen e shpenzimeve operative , shumen e planifikuar të faturimit dhe të shkallës së planifikuar të inkasimit nga KRU-të, ZRRUM ka aprovuar shuma të ndryshme të investimeve kapitale për vitin 2010.

Te disa kompani shuma e investimeve të planifikuara kapitale është ngritë për të fituar tarifa të caktuara , ndërkaj disa të tjerave shumat e tilla të planifikuara u janë zbrit.

Në tabelën vijuese mund të identifikohet se disa kompanive shuma e lejuar e investimeve vetanake kapitale u është ngritë, sikurse që është rasti i KRU-ve të: “Radoniqit”, “Hidroregjioni-Jugor” dhe “Hidromoravës”..

Ndërsa, KRU-ve të: “Prishtinës” dhe “Bifurkacionit” shumat e planifikuara për këtë destinim janë të përafërta me shumën e investimeve të aprovuara.

Ndërsa, “Hidrodriniit” të Pejës i cili kishte planifikuar një shumë të konsiderueshme të investimeve kapitale nga burimet vetanake për vitin 2010 e cila ka qenë e pamundur të vlerësohet si e bazuar i është reduktuar në 55,32% të shumës së tillë nga ZRRUM, për faktin se një shumë e tillë ishte e pamundur të mbulohej financiarisht gjatë vitit 2010 e njëjta gjë me ndryshime në përqindje (69,2%) vlen edhe për KRU “Mitrovica” sh. a. Mitrovicë.

Në nivel sektori, ZRRUM ka lejuar 93.1% të shumës së planifikuar të investimeve nga KRU-të prej burimeve financiare vetanake për vitin 2010. Ndërsa investimet e planifikuara prej donatorëve që të gjitha në marrëveshje me kompanitë ishin aprovuar sipas shumave të propozuara.

Tabela Nr. 9 Investimet kapitale të planifikuara nga KRU-të dhe të aprovuara nga ZRRUM prej burimeve vetanake dhe donacioneve.

		INVESTIMET VETANKAE			INVESTIMET NGA DONACIONET	
N r	Emri i Kompanisë	Investimet e planifikuara për 2010 (€)	Investimet e lejuara për 2010 (€)	%	Investimet e planifikuara për 2010 (€)	Investimet e lejuara për 2010 (€)
1	Prishtina	3,027,500	2,926,934	96.6%	27,773,340	27,773,340
2	Mitrovica	642,200	444,461	69.2%	516,000	516,000
3	Hidrodrini	1,242,200	687,137	55.3%	280,000	280,000
4	Radoniqi	811,325	1,142,693	140.8%	2,550,000	2,550,000
5	Hidroregjioni Jugor	692,800	712,997	102.9%	11,773,006	11,773,006
6	Bifurkacioni	985,000	933,177	94.7%	425,000	425,000
7	Hidromorava	375,950	395,865	105.3%	100,000	100,000
	Totali	7,776,975	7,243,264	93.1%	43,417,346	43,417,346

8.3 Investimet e realizuara gjatë periudhës 6 mujore të vitit 2010

ZRRUM i ka kushtuar rëndësi të veçantë çështjes së realizimit të Investimeve Kapitale prej burimeve vetanake të kompanisë, dhe për këtë, ka organizuar vizita sistematike duke u takuar me zyrtarë kompetent të KRU-ve, prej nga edhe kanë marrë të dhënat për investimet kapitale, të cilat janë të paraqitura në tabelë. Tashmë, mund të themi se bashkëpunimi i KRU-ve me ZRRUM-in është në nivel të kënaqshëm, dhe ata janë në dijeni për rolin e investimeve, si dhe implikimet që kanë investimet vetanake në tarifa, me të cilat janë ngarkuar konsumatorët.

Tabela e mëposhtme është e ndërlidhur me tabelën paraprake Nr. 9 e cila paraqet investimet e realizuara gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2010 prej burimeve vetanake të kompanisë si dhe nga donatorët e ndryshëm.

Tabela Nr. 10 Investimet e realizuara nga KRU-të prej burimeve vetanake dhe donacioneve gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2010 (Euro)

Emri i Kompanisë	Kategoria e Investimeve	Investimet e realizuara Vetanake			Investimet e realizuara nga Donacionet		
		Ujë	Kanalizim	Totali	Ujë	Kanalizim	Totali
Prishtina	Infrastrukturë	3,613	0	3,613	0	0	0
	Jo-Infrastrukturë	143,215	0	143,215	0	0	0
	Totali	146,828	0	146,828	0	0	0
Mitrovica	Infrastrukturë	0	0	0	0	0	0
	Jo-Infrastrukturë	0	0	0	536,609	0	536,609
	Totali	0	0	0	536,609	0	536,609
Hidrodrini	Infrastrukturë	22,475	1,573	24,048	43,344	0	43,344
	Jo-Infrastrukturë	0	0	0	0	0	0
	Totali	22,475	1,573	24,048	43,344	0	43,344
Radoniqi	Infrastrukturë	11,056	0	11,056	0	0	0
	Jo-Infrastrukturë	0	0	0	0	0	0
	Totali	11,056	0	11,056	0	0	0
Hidroregjioni Jugor	Infrastrukturë	28,100	0	28,100	364,879	0	364,879
	Jo-Infrastrukturë	50,057	0	50,057	0	0	0
	Totali	78,157	0	78,157	364,879	0	364,879
Bifurkacioni	Infrastrukturë	4,885	11,739	16,624	213,895	1,017,519	1,231,414
	Jo-Infrastrukturë	0	0	0	0	0	0
	Totali	4,885	11,739	16,624	213,895	1,017,519	1,231,414
Hidromorava	Infrastrukturë	22,500	0	22,500	87,000	0	87,000
	Jo-Infrastrukturë	0	0	0	0	0	0
	Totali	22,500	0	22,500	87,000	0	87,000
Totali i investimeve		285,901	13,311	299,212	1,245,726	1,017,519	2,263,245

Për të pasur më të qartë se sa është shkalla e realizueshmërisë së investimeve, janë paraqitur edhe dy tabela tjera të cilat tregojnë shumën e planifikuar dhe të aprovuar për vitin 2010 si dhe shumën e realizuar gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2010. Të dhënat si të tilla, janë paraqitur të ndara për investimet e realizuara Vetanake dhe investimet nga Donatorët e ndryshëm.

Tabela Nr. 11 Shuma e investimeve **vetanake** të planifikuara nga KRU-të dhe të aprovuara prej ZRRUM për vitin 2010, si dhe të realizuara nga KRU-të gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2010 (Euro)

INVESTIMET VETANKAE						
Nr	Emri i Kompanisë	Investimet e planifikuara për 2010	Investimet e lejuara për 2010	Investimet e realizuara gjatë 6 mujorit të 2010	% 6-mujore e investimeve të realiuara	Vlerësimi përfundimtar 6 mujor
1	Prishtina	3,027,500	2,926,934	146,828	5.02	Negativ
2	Mitrovica	642,200	444,461	0	0.00	Negativ
3	Hidrodrini	1,242,200	687,137	24,048	3.50	Negativ
4	Radoniqi	811,325	1,142,693	11,056	0.97	Negativ
5	Hidroregjion i Jugor	692,800	712,997	78,157	10.96	Negativ
6	Bifurkacioni	985,000	933,177	17,872	1.92	Negativ
7	Hidromorava	375,950	395,865	22,500	5.68	Negativ
	Totali	7,776,975	7,243,264	300,461	4.15	Negativ

Tabela Nr. 12 Shuma e investimeve nga **donacionet** të planifikuara nga KRU-të dhe të aprovuara prej ZRRUM për vitin 2010, si dhe të realizuara nga KRU-të gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2010 (Euro)

INVESTIMET NGA DONACIONET						
Nr	Emri i Kompanisë	Investimet e planifikuara për 2010	Investimet e lejuara për 2010	Investimet e realizuara gjatë 6 mujorit të 2010	% 6-mujore e investimeve të realizuara.	Vlerësimi përfundimtar 6-mujor
1	Prishtina	27,773,340	27,773,340	0	0	Negativ
2	Mitrovica	516,000	516,000	536,609	104	Pozitiv
3	Hidrodrini	280,000	280,000	43,344	15	Negativ
4	Radoniqi	2,550,000	2,550,000	0	00	Negativ
5	Hidroregjioni Jugor	11,773,006	11,773,006	364,879	3	Negativ
6	Bifurkacioni	425,000	425,000	1,279,096	301	Pozitiv
7	Hidromorava	100,000	100,000	87,000	87	Pozitiv
	Totali	43,417,346	43,417,346	2,310,928	5.32	Negativ

Investimet e planifikuara nga KRU-të dhe të aprovuara nga ZRRUM në këtë tabelë janë ato të shumave vjetore dhe të njëjtat janë monitoruar për përmbushje vetëm për 6-mujorin e parë të vitit 2010. Për këtë, vlerësimi përfundimtar (Pozitiv/Negativ) bëhet duke u bazuar në atë që e theksua më lartë; nëse një KRU ka realizuar më shumë se 50% të investimeve të aprovuara nga ZRRUM atëherë ka vlerësim pozitiv, ndërsa nëse një KRU ka realizuar më pak se 50% të investimeve të aprovuara atëherë ka vlerësim negativ.


Vlen të theksohet se investimet e donatorëve të ndryshëm janë të mirëseardhura shumë të vlerësuara nga KRU-të, ZRRUM dhe shoqërinë në përgjithësi. Prandaj, ZRRUM ka aprovuar që të gjitha ato..

Për secilën KRU, DFTRR/ZRRUM ka të sistemuar dhe të kategorizuar të gjitha investimet, projekt për projekt, në të cilat pasqyra janë të paraqitura edhe burimet e financimit. Këto shënime janë të hapura dhe në to mund të kenë qasje të gjitha palët e interesuara.


8.5 Paraqitja grafike e investimeve kapitale

Diagramet e mëposhtme shprehin në mënyrë grafike investimet e planifikuara, aprovuara dhe të realizuara nga burimet vetanake si dhe të atyre prej donacioneve, si të tilla do të paraqiten pa e bërë ndonjë komentim nga ZRRUM.

Diagrami Nr. 11 Shuma e investimeve vetanake të planifikuara, lejuara dhe realizuara



Diagrami Nr. 12 Shuma e investimeve të planifikuara, lejuara dhe realizuara nga donacionet



Disa konstatime:

Edhe pse kompanive u është dhënë rasti për ti komentuar gjetjet sipas këtij raporti periodik 6-mujorë, pasi që të njëjtat për këtë janë njoftuar që nga data 12 tetori 2010, ato nuk kanë bërë një gjë të tillë, për të cilat mund të konkludohet se nuk kanë pas ndonjë arsye për ti komentuar gjetjet e tij, ose e kanë neglizhuar. Sidoqoftë, i njëjti tani ka marr formën përfundimtare.

Kompanitë duhet të kenë parasysh faktin se mos investimi i kapitalit të vet financiarë do ta ulën vlerën e aseteve të tyre vit pas viti dhe nga aspekti ekonomik është një trend shumë negativë që po zgajt me vite dhe kjo është e pa tolerueshme.

Kërkohet nga kompanitë që të shtojnë përpjekjet e tyre për realizim të objektivave të përcaktuara për pjesën e mbetur të vitit aktual, përndryshe vlerësimi i përgjithshëm është tejet negativë e cila vështirë mund të arsyetohet.

Prishtinë, Tetor 2010

Përgatitur nga:
DFTRR/ZRRUM, Prishtinë